



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
Ministri

Nr. 201 / 8 Prot.

Tiranë, më 28.5. 2013

URDHËR

Nr. 201, datë 28.5.2013

PËR

**RIORGANIZIMIN E NJËSIVE KRYESORE “FAKULTETI I SHKENCAVE EKONOMIKE”,
“FAKULTETI I SHKENCAVE POLITIKE” DHE “FAKULTETI I MARRËDHËNIEVE
NDËRKOMBËTARE” NË “FAKULTETI I SHKENCAVE EKONOMIKE” DHE “FAKULTETI I
SHKENCAVE JURIDIKE DHE POLITIKE” NË INSTITUCIONIN “SHKOLLA E LARTË
PRIVATE MESDHETARE E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikave 5 dhe 6 të Nenit 41 të Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ,

URDHËROJ:

1. Riorganizimin e njësive kryesore “Fakulteti i Shkencave ekonomike”, “Fakulteti i shkencave politike” dhe “Fakulteti i marrëdhënieve ndërkombëtare” në “Fakulteti i Shkencave ekonomike” dhe “Fakulteti i shkencave juridike dhe politike” në Institucionin “Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë”, në përputhje me Vendimin nr. 444, datë 03.05.2013 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Njësia kryesore “Fakulteti i Shkencave ekonomike” të ketë në përbërje këto njësi bazë:
 - a. Departamenti i ekonomisë;
 - b. Departamenti financë-bankë dhe kontabilitet;
 - c. Qendër kërkimore.

3. Njësia kryesore “Fakulteti i shkencave juridike dhe politike” të ketë në përbërje këto njësi bazë:
 - a. Departamenti i së drejtës dhe administratës;
 - b. Departamenti i shkencave politike dhe ndërkombëtare;
 - c. Qëndër kërkimore.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Këshilli i Akreditimit, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit të Lartë, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe Institucioni “Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë”.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MYQEREM TAJF



MINISTËR

